

VENDIM
Nr. 323, datë 16.5.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 916, DATË 28.12.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2012, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 pika 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 639 veta. Shtesa prej 118 punonjësish është e detajuar sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2012, të njësive të qeverisjes qendrore. Përgjashtimisht për 110 punonjësit e Ministrisë së Brendshme, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet buxhetore të përmendura sipas lidhjes nr. 3, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008 “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha